



ANALIZË E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Tiranë, nëntor 2020

ANALIZË E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Hartoi raportin:

Bledar Karoli, ekspert i kontraktuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Kontribuan në hartimin e raportit:

Shoqata “Together for Life”

Qendra për Arsim Cilësor

Kjo analizë u përgatit në kuadër të projektit rajonal të antikorrupsionit “Për më shumë transparencë dhe llogaridhënie në adresimin e korrupsionit nëpërmjet monitorimit të procedurave të prokurimit publik në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë”. Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit.



© Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Tiranë, nëntor 2020

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Ligji për prokurimin publik është një ndër instrumentet kryesore strategjike që ndihmon qeverinë të arrijë objektivat ekonomike, sociale dhe të mjedisit nëpërmjet një sistemi të përgjegjshëm, efektiv dhe transparent të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve të qeverisë. Nisur nga rëndësia që ka prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve me qëllim garantimin e mirë përdorimit të fondeve publike dhe parandalimin e keqpërdorimit, korrupsionit dhe mashtrimit, Ligji shqiptar nr. 103/2018 “Për prokurimet publike” ka parashikuar një sërë rregullash dhe procedurash që duhen respektuar nga autoritetet kontraktuese. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimet publike ka pësuar ndryshime të shpeshta, gjë e cila ka ndikuar në kapacitetet e autoriteteve kontraktuese për njohjen dhe respektimin e duhur të procedurave që duhen ndjekur në prokurimin publik të mallrave, shërbimeve dhe punëve.

Rritja e transparencës dhe përgjegjësisë, në veçanti sigurimi i funksionimit efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike vlerësohet si thelbësor në Raport Progresin e Komisionit Europian për Shqipërinë¹. Institucionet ndërkombëtare në raportet e tyre për Shqipërinë shpesh kanë shprehur shqetësimin në lidhje me natyrën endemike të korrupsionit në të gjitha fushat e jetës publike dhe private, duke përfshirë edhe atë të prokurimit publik. Megjithëse ky shqetësim është i bazuar në realitetin ekzistues, Komisioni Europian në raportin mbi korrupsionin² në Bashkimin Evropian (BE), në kapitullin që fokusohet mbi korrupsionin në prokurimin publik, në mënyrë të qartë tregon se një numër shtetesh anëtare të BE-së gjithashtu po përballen me probleme të ngjashme me ato të Shqipërisë. Disa prej gjetjeve të këtij raporti i janë referuar rastit të Shqipërisë. Fakti që disa prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian po përballen me të njëjtin problem nuk mund të përbëjë justifikim për dështimin e vazhdueshëm të shtetit shqiptar në ngritjen e një sistemi efektiv dhe transparent të prokurimit publik. Kjo do të thotë se sfidat me të cilat po përballen Shqipëria në këtë fushë janë të vështira dhe nuk pritet të përmbushen lehtë ose brenda një afati të shkurtër kohor. Megjithatë, është i dobishëm shqyrtimi i natyrës dhe shkallës së problemeve në shtetet anëtare të BE-së, të cilat kanë probleme në këtë fushë, me qëllim që të përfitohet nga përvojat e tyre për të parashikuar sfidat e së ardhmes dhe për të mos përsëritur të njëjtat gabime. Pothuajse 1/5 e GDP-së së BE-së shpenzohet çdo vit nga ana e autoriteteve publike në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe 20% e këtij totali lëvrohet përmes procedurave të prokurimit publik, për pasojë, prokurimi publik është një objektiv i qartë për ata që janë përfshirë në praktika korruptive. */

Një ndër zhvillimet pozitive, e vlerësuar dhe si një masë për të parandaluar korrupsionin dhe nxitur transparencën është platforma elektronike e prokurimeve publike (e_prokurimet), e cila është e detyrueshme për t’u përdorur nga të gjithë autoritetet publike, edhe për kontratat me vlerë të vogël. Planifikimi dhe përgatitja e procedurave të prokurimit publik është përgjithësisht transparente, dhe parashikimet e prokurimit publik publikohen në mënyrë të rregullt. Shqetësim mbetet përdorimi i diskutueshëm i procedurave të prokurimit publik dhe përjashtimi i partneritetit publik privat nga rregullat e prokurimit publik në disa sektorë të veçantë.

¹ Shih Raport Progresin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2020

² https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/e-library/documents/policies/organized-crime-and-human-trafficking/corruption/docs/acr_2014_en.pdf

Për sa i përket formës së shfaqjes së korrupsionit në procedurat e prokurimit publik, kërkimet kanë treguar se katër llojet e mëposhtme të praktikave korruptive duket që janë dominuese:

“[...] (1) manipulimi në tendera (në formën e fshehjes së ofertës, ofertat plotësuese, rotacionit të ofertës dhe nënkontraktimit), kur kontrata i është “premtuar” një kontraktori me ose pa pëlqimin e zyrtarit publik;

(2) shantazhi, kur zyrtari publik, i cili do të marrë pjesë në procesin e tenderimit, duke përfshirë edhe procesin administrativ kërkon ose pranon një ryshfet;

(3) konflikti i interesit;

(4) parregullsi të tjera, duke përfshirë keqmenaxhimin e qëllimshëm/paditurinë, kur zyrtarët publikë nuk kryejnë kontrollet e duhura apo nuk ndjekin procedurat e nevojshme dhe tolerojnë ose injorojnë keqadministrimin e hapur dhe të qëllimshëm nga kontraktorët.³”

Prokurimi publik është një instrument në funksion të realizimit të interesit publik, i cili dekadat e fundit, që përkojnë me fazën e kontraktualizmit në sektorin publik, së bashku me skema të tjera, ka pasur një përdorim gjithnjë e më të gjerë dhe rrjedhimisht ka qenë objekt i një rregullimi në përmirësim të vazhdueshëm.

Në legjislacione të ndryshme mbi prokurimin publik gjejmë përkufizime të ndryshme në lidhje me të. Megjithatë, në thelb prokurimi publik mund të përkufizohet si një *instrument i përdorur nga autoritet publike qendrore dhe vendore ose organe të tjera që veprojnë nën regjimin e drejtës publike me qëllim blerjen e mallrave, shërbimeve, si dhe kryerjen e punëve publike me fonde shtetërore.*

Ligji shqiptar nr. 103/2018 “Për prokurimin publik” jep përkufizimin e kontratës publike si *“kontrata me shpërbim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt (i) kryerjen e punimeve, (ii) furnizimin e mallrave dhe (iii) shërbimeve. Më tej jepet dhe përkufizimi për secilën nga këto tri kontrata.*

Kontratat për punë publike kanë si objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Kontratat publike furnizimi kanë si objekt blerjen, blerjen me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave.

Kontratat publike për shërbime kanë si objekt kryerjen e shërbimeve.

³ Bazuar në përkufizimin e Bankës Botërore, “kapja e shtetit” mund të përkufizohet si përpjekjet e elitës/grupeve të interesit për të ndikuar në miratimin e ligjeve, politikës dhe rregullave me anë të mënyrave të paligjshme. Mund të konstatohen forma të ndryshme të “kapjes së shtetit”, bazuar në tipet e kapjes së institucioneve (psh. ekzekutive apo gjyqësore), ose kush bën “kapjen” (psh. firmat private/ partitë politike /funksionarët publikë) dhe llojet e përfitimeve (psh. korrupsioni, nxjerrja e informacioneve konfidenciale). Shiko Banka Botërore, Antikorrupsioni në Tranzicion: Kontributi në Debatin Politik, 2000.

Lidhja e këtyre kontratave detyrimisht duhet të paraprihet nga një procedurë dhe tërësi rregullash të parashikuara nga ligji.

Duke filluar prej vitit 2018 është në proces hartimi i një projektligji të ri për prokurimin publik. Nevoja për hartimin e këtij projektligji ka ardhur si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit legjislativ për prokurimin publik, nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Banka Botërore, OECD/SIGMA, rekomandime të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si rezultat i problematikave të ndryshme të hasura në praktikë gjatë procesit të prokurimit apo edhe kërkesave për ndryshime nga institucione të ndryshme, sipas fushave respektive të kompetencës.

Objektivat konkretë që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji, janë:

- përafrimi i legjislacionit shqiptar me *Acquis* e BE-së,
- lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit,
- shmangia e zvarritjes së procesit të prokurimit për shkak të tejzgjatjes së ankimit administrativ,
- lehtësimi i prokurimeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, si dhe
- rritja e performancës në implementimin e kontratave nëpërmjet forcimit të monitorimit të këtij procesi.

Të dhënat për prokurimin publik për vitin 2018

Sikundër tregohet edhe nga shifrat dhe të dhënat e përpunuara në këtë kuadër, fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2017 shkon mesatarisht nga 7-12% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Konkretisht, sikundër paraqitet edhe në grafikun më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezultojnë se:

1. Kosova: Sipas raportit të Komisionit Evropian⁴, në vitin 2017 prokurimi publik arriti në 7.35% të PBB, me një vlerë prej 459.7 milionë Eurosh.
2. Serbia⁵: Sipas raportit të Komisionit Evropian, në gjysmën e parë të vitit 2017 prokurimi publik arriti në rreth 7.2% të PBB, duke pësuar një rënie të lehtë nga përqindja e vitit 2016, kur prokurimi publik zinte 8% të PBB-së.
3. Mali i Zi⁶: Sipas raportit të Komisionit Evropian, bazuar në të dhënat paraprake, në vitin 2017 prokurimi publik zë 10% të PBB-së krahasuar me 11.8% në 2 vitet e mëparshme.
4. Maqedonia⁷: Sipas raportit të Komisionit Evropian, prokurimi publik përfaqëson 10% të PBB-së.
5. Shqipëria⁸: Sipas raportit vjetor të vitit 2017, të publikuar nga APP-ja, prokurimi publik për vitin 2017 zinte rreth 7% të PBB-së.


⁴ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

⁵ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-serbia-report.pdf>

⁶ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-montenegro-report.pdf>

⁷ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

⁸ Analiza vjetore 2018, APP, pg. 10



Burimi: Të dhëna të marra nga Raportet e Komisionit Europian për vendet e Rajonit.⁹

Ndërkohë, nga përpunimi i të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe bazuar në të dhënat e siguruar nga INSTAT-i dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), rezulton se për vitin 2018 fondi total limit i prokuruar zë 7.8% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin fond total limit i prokuruar-PBB:

Tabela 1

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Prodhimi i Brendshëm Bruto	1,647,625,000,000
Fondi total limit i prokuruar në Republikën e Shqipërisë	129,819,994,300
Fondi total limit i prokuruar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB-në (në %)	7,8%

⁹ Shih ne Link raportet nga numrat 4,5,6,7.

Në tabelen e mëposhtme paraqitet shpallja e procedurave të prokurimit për vitin 2018 sipas tipit të kontratës të krahasuar me vitin 2017.

Publikime Procedura Konkurruese Janar -Dhjetor sipas Tipit të kontratës		
Viti	2017	2018
Shërbime	2098	2,542
Mallra	3899	4,475
Punë	1320	1,383
Numri Total i Procedurave	7317	8400
Vlera totale Fondi limit	109,619,600,197	129,819,994,300

Siç vërehet nga të dhënat e përpunuara, numrin më të madh të procedurave të shpallura e zënë procedurat për prokurimin e mallrave me 4,475 procedura të shpallura në total ose 53.2% të procedurave të shpallura (576 më shumë se në vitin 2017), duke vijuar me procedurat për prokurimin e shërbimeve 2,542 (444 më shumë se në vitin 2017) dhe të punëve civile 1,383 (63 më shumë se në 2017-n).

Të dhënat për prokurimin publik për vitin 2019


Fondi buxhetor i shpenzuar për prokurime publike në vendet e rajonit për vitin 2018 shkon mesatarisht nga 8-10% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Konkretisht, sikundër paraqitet edhe në grafikun nr. 2 më poshtë, sipas të dhënave të publikuara rezulton se:

- 1- Kosova: Sipas raportit të Komisionit Evropian, në vitin 2018 prokurimi publik arriti në 9.6% të PBB-së, me një vlerë prej 631.6 milionë Euro.
- 2- Serbia: Sipas raportit të Komisionit Evropian, në vitin 2018 prokurimi publik arriti në rreth 8% të PBB-së, duke pësuar një rritje të lehtë nga përqindja e vitit 2017, kur prokurimi publik zinte 7.7% të PBB-së.
- 3- Mali i Zi: Sipas raportit të Komisionit Evropian, bazuar në të dhënat paraprake, në vitin 2018 prokurimi publik zë 9.1% të PBB-së krahasuar me 10% dhe 11.8% në dy vitet e mëparshme.
- 4- Maqedonia e Veriut: Sipas raportit të Komisionit Evropian, në vitin 2018 prokurimi publik përfaqëson 9% të PBB-së.
- 5- Shqipëria: Sipas raportit vjetor të vitit 2018, publikuar nga APP-ja, prokurimi publik për vitin 2018 zinte rreth 7.8% të PBB-së.



Tabela dhe grafiku i mëposhtëm paraqesin të dhënat në lidhje me raportin fond total limitit i prokuruar - PBB:

Treguesi makroekonomik	Vlera (në miliardë Lekë)
PBB- Prodhimi i Brendshëm Bruto	1,705,246,000,000
Fondi total limitit i publikuar në Republikën e Shqipërisë	110,664,365,109
Fondi total limitit i publikuar në Republikën e Shqipërisë në raport me PBB-në (në %)	6.5%



Që prej janarit 2018, Regjistrat e Parashikimeve dhe Realizimeve përgatiten elektronikisht dhe publikohen në sistemin e prokurimit elektronik. Automatizimi i këtyre dy regjistrave ka pasur një rëndësi shumë të madhe për rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve kontraktore në planifikimin e nevojave që do të prokurojnë gjatë vitit në vijim, si dhe operatorët ekonomikë arrijnë që në kohë reale të kenë informacion mbi të gjitha procedurat dhe fondet publike që do të prokurohen gjatë vitit, duke rritur në mënyrë të dukshme transparencën në lidhje me përdorimin dhe

mirëmenaxhimin e fondeve publike. Megjithatë, kontratat e prokurimit publik të marra në objekt monitorimi të këtij projekti kanë qënë të pamundura për t'u gjetur nga organizatat implementuese në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve. Nga informacionet e mbledhura nga Agjencia e Prokurimit Publik na rezulton se të gjithë regjistrat ekzistojnë, por subjektet e jashtëm hasin vështirësi dhe e kanë të pamundur gjetjen e tyre.

Nga të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Parashikimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2019 rezulton se janë miratuar dhe publikuar rreth 38,732 elemente të regjistrave për parashikimin e prokurimeve dhe ndryshimet në regjister të kryera gjatë vitit nga autoritetet kontraktore.

Në këtë seksion paraqiten të dhënat e detajuara lidhur me procedurat e prokurimit, duke përfshirë procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe procedurat me vlerë të vogël të zhvilluara në Republikën e Shqipërisë gjatë vitit 2019.

Procedura konkurruese dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar - Dhjetor 2019	
Numri Total i Procedurave/lotet të publikuara konkurruese	7.384
Fondi total limit i për procedurat/lotet e publikuara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	110,664,365,109
Numri Total i procedurave/lotet të cilat kanë vazhduar	5.216
Fondi total limit i prokuruar i proceduravetëcilat kanë vazhduar (vlera në lekë pa TVSH)	92,191,716,425
Numri Total i Procedurave/lotëve të fituara konkurruese	5.703
Fondi total limit i prokuruar i procedurave/lotëve të fituara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	87,958,991,776
Vlera totale e fituar e procedurave/lotëve të fituara konkurruese (vlera në lekë pa TVSH)	80,122,989,108
Numri Total i Procedurave me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	192
Fondi total limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë pa TVSH)	2,338,820,945
Vlera totale e fituar për procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (vlera në lekë pa TVSH)	2,280,708,225
% që zë nr i procedurave me negociim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (konkurruese +negocim pa shpallje)	3.2%
% që zë fondi limit i prokuruar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj fondit total limit të prokuruar për procedurat e fituara (konkurruese +negocim pa shpallje)	2.6%
% që zë vlera e fituar për procedurat me negociim pa shpallje ndaj vlerës totale të fituar për procedurat e fituara (konkurruese +negocim pa shpallje)	2.8%

Numri Total i Procedurave/lotëve të fituara (konkurrese +negocim pa shpallje)	5895
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara/lotëve (konkurrese +negocim pa shpallje) vlera në lekë pa TVSH	90,297,812,721
Vlera totale e fituar i procedurave/lotëve të fituara (konkurrese +negocim pa shpallje)vlera në lekë pa TVSH	82,403,697,333
% që zë Vlera totale e fituar ndaj Fondit total limit të prokuruar	91.3%
Vlera totale e kursyer në lekë pa TVSH	7,894,115,388
% që zë Vlera totale e Kursyer ndaj Fondit total limit të prokuruar	8.7%

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten me grafik numri i procedurave të publikuara në mënyrë krahasimore sipas llojit të procedurës, respektivisht në vitin 2018 dhe 2019.



Në kushtet kur operatorët që janë pjesë e një bashkimi të përkohshëm për qëllime të realizimit të një kontrate publike, veçanërisht në ato për punë publike, marrin përsipër të realizojnë një pjesë të caktuar të kësaj kontrate, duhet të zotërojnë kapacitetet përkatëse në përputhje me pjesën e punëve/shërbimeve/ furnizimeve që kanë marrë përsipër të realizojnë.

Konstatimet dhe gjetjet e evidentuara në raportet e auditeve të cilat i referohen kontrollit të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës 2014-2019, konsistojnë kryesisht në:

- ✓ Mungesën e argumentimit dhe dokumentimit të përgatitjes së specifikimeve teknike. Në disa procedura të audituara që kanë objekt sisteme elektronike, është konstatuar mungesë e dokumentimit të procesit të hartimit të projektit, si dhe evidentimit të grupit të punës që ka përgatitur dhe miratuar projektin përkatës.
- ✓ Mungesën e përllogaritjes së fondit limit dhe dokumentimit përkatës.

- ✓ Mungesën e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe hartimin e kriterëve për kategoritë e licencave, stafin teknik, çertifikata ISO, disponimin e lejeve dhe/apo licencave të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.
- ✓ Në disa procedura është vërejtur kërkesë e autoritetit kontraktor për posedimin e certifikatave ISO nga secili operator ekonomik në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që duhet të disponohen sipas natyrës së punimeve që secili anëtar merr përsipër të realizojnë. Gjithashtu, është evidentuar kërkesë e autoritetit, sipas së cilës çdo anëtar i bashkimit të operatorëve të disponojë mjekun e shoqërisë, pa specifikuar se mjeku është detyrim vetëm për shoqëritë e ndërtimit që kanë mbi 15 punonjës të siguruar.
- ✓ Disa autoritete kontraktore të pushtetit vendor kërkojnë nga ofertuesit në kriteret e veçanta të kualifikimit, vërtetim të lëshuar nga vetë këto autoritete mbi shlyerjen e taksave vendore për një periudhë të caktuar kohore. Ndërkohë, ekzistenca apo jo e detyrimeve të operatorëve ekonomikë është një informacion që disponohet dhe është lehtësisht i verifikueshëm nga vetë autoriteti kontraktor, duke e bërë të panevojshëm përcaktimin e një kriteri të tillë.

Ligji i ri synon të përmirësojë ndjeshëm sistemin e prokurimit në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit dhe plotësimit të mangësive të evidentuara në dispozitat ekzistuese dhe futjes së parashikimeve të reja për të plotësuar boshllëqet ligjore të evidentuara deri tani.

Një e dhënë mjaft e rëndësishme për analizën që jemi duke hartuar jepet edhe nga raportet e auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat për periudhën kohore 2018 dhe 2019 rezultojnë si më poshtë të cituara nga Progres Raportet për Shqipërinë:

“Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton një numër të madh parregullsish në prokurimin publik më një vlerë financiare dhe humbje për buxhetin e shtetit në rreth 12 milionë Euro në 2017-n krahasuar me 25,6 milionë Euro në 2016-n dhe përafërsisht 18,8 milionë Euro në 2015-n, ndërkohë që në vitin 2019 humbjet kanë qenë rreth 13.9 milion Euro, dhe në 2018 9.4 milion Euro ne 2018.”

Krahas kësaj analize të përgjithshme në kuadër të këtij projekti janë marrë në shqyrtim 6 kontrata prokurimesh publike në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë, me synim për të monitoruar hap pas hapi ndjekjen e procedurave dhe rregullave përkatëse. Ky monitorim është bazuar në informacionin e ofruar nga vetë autoritetet kontraktuese mbas kërkesave për informacion të adresuara nga dy organizatat implementuese të këtij projekti, përkatësisht Shoqata Together for Life dhe Qendra për Arsim Cilësor. Përzgjedhja e kontratave të prokurimit publik është bërë në bashkëpunim me organizatat e tjera në nivel lokal dhe grupet informale përkatësisht në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. Një informacion më të detajuar për secilën kontratë të monitoruar e gjeni në faqet në vijim.

Analizë e detajuar e kontratave të miratuara

I. Kontratë Prokurimi Publik : Nr. REF- 84140-08-29-2018.

Objekt : Pajisje kompjuterike dhe elektronike,

Autoritet Kontraktor: Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Organizata “Për arsim cilësor” për sigurimin e dokumentave të procedurës së prokurimit publik i është drejtuar, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për te drejtën e informimit” me kërkesë për informacion autoritetit kontraktor Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Universiteti ka vënë në dispozicion dokumentacionin e procedurës, i cili sipas parashikimeve ligjore lejohet të aksesohet nga publiku. Kontrata e prokurimit rezulton në Regjistrimin e Parashikimeve të Autoritetit Kontraktor si procedurë prokurimi, e hapur, me fond limit 10,880,500 lekë pa TVSH parashikuar për t’u zhvilluar brenda vitit 2018. Ftesa për ofertë e prokurimit publik është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike (në Buletinin e Njoftimeve Publike), pranë APP-së.

Në datën 29.08.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-84140-08-29-2018 me objekt: “Pajisje kompjuterike dhe elektronike” me fond limit 10,880,500 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Në datën 05.10.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultojnë pjesëmarrës operatorët si më poshtë vijon:

- Euro Inform, pa ofertë, i skualifikuar
- Paera, pa ofertë, i skualifikuar
- ÇS, pa ofertë, i skualifikuar
- Atom, 9,875,000 i kualifikuar
- BNT Electronics, 9,982,533 i skualifikuar
- PC Store, 10,799,960 i kualifikuar I

Në datën 10.10.2018 operatori ekonomik “PC Store” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës. Në datën 25.10.2018 pala ankimuese “PC Store” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimimi ka vendosur pranimin e ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” shpk dhe ka anuluar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Atom” shpk duke e skualifikuar atë për shkak se:

- nuk plotëson kritere mbi kapacitet teknike;
- nuk ka paraqitur deklaratën mbi origjinën e artikujve të kërkuar;
- nuk ka paraqitur katalogët dhe deklarinimin për të gjithë artikujt;
- nuk garanton produkte të reja dhe origjinale;
- nuk ka paraqitur deklaratë konformiteti të artikujve;
- mungojnë disa specifikime në gjuhën angleze.

Organizata raporton se, të dhënat specifike që kanë të bëjnë me fituesin e përzgjedhur, si raportet financiare, xhirot vjetore, bilancet apo informacione të tjera sensitive nuk janë vënë në dispozicion sepse janë konsideruara konfidenciale.

Nisur nga sa më sipër sqaruar në lidhje me procedurën e prokurimit dhe në pamundësi për vënies në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm është konsultuar Raporti i Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit i vitit 2019 në të cilin rezulton se: “[...] disa prej procedurave rezultuan në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007, “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndër to rezulton edhe procedura në objekt të këtij raporti.

Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se është respektuar baza ligjore për prokurimin publik dhe si pasojë procedura e prokurimit përmbush standardet e ligjshmërisë.

Ajo që konstatohet është pjesëmarrja e ulët e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë. Autoriteti Kontraktor ka vendosur kualifikimin e çmimit më të ulët ndërkohë që Komisioni i Prokurimit i Publik ka kualifikuar ofertën me vlerë më të lartë ekonomike. Kualifikimi i ofertës më të ulët nga ana e autoritetit kontraktor mund të ketë qënë një prej arsyeve të konsiderimit të kësaj procedure si në zbatim të legjislacionit për prokurimit publik nga ana e autoritetit auditues KLSH.

II. Kontratë Prokurimi Publik : REF-77391-07-02-2018

Objekt : Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO" Leskovik

Autoritet Kontraktor : Bashkia Kolonjë

Pas kërkesës për informacion të adresuar nga organizata “Për arsim cilësor” Bashkisë Kolonjë, kjo e fundit ka vënë në dispozicion dokumentacionin e procedurës. Kontrata e prokurimit rezulton në Regjistrimin e Parashikimeve të autoritetit kontraktor si procedurë prokurimi, e hapur, me fond limit 62.756.087 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në vitin 2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-77391-07-02-2018 me objekt “Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO" Leskovik , Bashkia Kolonjë”, me fond limit 62.756.087 leke pa TVSHNë datën 02.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe është zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë. Pas përfundimit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Elda-VI pa ofertë i skualifikuar
- Duro pa ofertë i skualifikuar
- Shendelli 48,323,390 i skualifikuar
- Alba Konstruksion 50,718,651 i kualifikuar
- Aurora Konstruksion 50,787,838 i skualifikuar

- Kacdedja 54,970,620 i skualifikuar

Bashkimi i operatorëve BOE “Kacdedja” & “Agri Construction” sh.p.k pas njoftimit të skualifikimit nga procedura e prokurimit ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij si dhe më pas është ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

KPP ka konstatuar se ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike është skualifikuar për 6 arsye, ndërkohë në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor ka ngritur pretendime vetëm për tri prej tyre, konkretisht lidhur me ofertën ekonomike, fabrikën e asfaltobetonit dhe kontratën e furnizimit për bojra hidroplastike lidhur me shoqërinë Delta. Për arsyet e tjera të sipërcituara BOE ankimues nuk ka parashtruar asnjë fakt/argument me anë të të cilit të kundërshtojë pretendimet e autoritetit kontraktor për mangësitë e konstatuara në kontratat e furnizimit për këto arsye. Në këtë kuptim, KPP gjykon se ankimi i paraqitur prej bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi në autoritetin kontraktor dhe KPP nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”. KPP kontaton se për kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit lidhur me kontratat e furnizimit ankimuesi ka pretenduar me një fjali se i ka dorëzuar të gjitha ato sipas kërkesave të autoriteti kontraktor, por nuk ka ngritur asnjë kundërshtim konkret lidhur me mangësitë e konstatuara nga ky i fundit.

KPP gjykon se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij dhe të japë argumenta konkretë që dëshmojnë se ai i përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe të argumentojë se për çfarë arsyesh pretendimet e autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e tij nuk qëndrojnë. KPP gjykoj se mosankimimi në tërësi i arsyeve të skualifikimit bën që BOE “Kacdedja” & “Agri Construction” shpk të mbeten të skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi cilido qoftë fati i arsyeve të tjera të skualifikimit për të cilën ankimuesi ka iniciuar procedimin administrativ. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me arsyet e skualifikimit lidhur me ofertën ekonomike, kontratën e furnizimit me beton dhe kontratën e furnizimit me bojra hidroplastike do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi për arsyet e tjera të skualifikimit, nuk është ngritur asnjë pretendim pranë autoritetit kontraktor, cka sjell se gjendja faktike dhe juridike e BOE ankimues do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin. Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

Komisioni i Prokurimit Publik në këtë mënyrë nuk ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes duke lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktor Bashkisë Kolonjë.

Nuk është mundur të sigurohet raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për këtë bashki, por është konsultuar website i dedikuar prokurimit publik Open Procurement Albania¹⁰ i cili pasqyron të gjitha procedurat e prokurimit publik të zhvilluara në vend. Në lidhje me këtë procedurë kontatohet vendosja e një Red Flag (flamuri te kuq) për arsyen e skualifikimit të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe kualifikimin e vetëm një operatori ekonomik atë fitues.

Në konkluzion konstatojmë se është respektuar baza ligjore për prokurimin publik, por në vlerësimin e kësaj procedure nuk është zbatuar Neni 1 i Ligjit “ Për Prokurimin Publik” i cili përcakton rregullat kryesore që duhet të zbatuar.

Skualifikimi i të gjithë operatorëve ekonomikë legjitimon skepticizmin për moszbatim të ligjshmërisë nga ana e autoriteti kontraktor. Gjithashtu, konstatojmë se edhe Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka vendosur bazuar në parimin e vendosjes së ligjshmërisë, por ka zbatuar në mënyrë shabllon ligjin “Për prokurimin publik” duke mos marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik pasi kjo nuk rezultonte e plotë. Sjellim këtu në vëmendje se ky institucion si është organi më i lartë dhe vendimarrës në fushën e prokurimit publik ka mundësi të shqyrtojë gjithë procedurën në themel dhe të vendosë mbi ligjshmërinë e saj bazuar në interesin e operatorëve ekonomikë, por edhe në zbatimin të mbrojtjes së interesit publik dhe menaxhimit sa më të mirë të fondeve publike.

Për të përdorur të njëjtën mënyrë vlerësimi si Open Procurement kemi të bëjmë me nje “Red Flag” pra flamur të kuq alarmi jo vetëm në rastin e autoritetit kontraktor, por edhe te Komisioni të Prokurimit Publik duke e bërë kështu procedurën me dy flamuj të kuq mbi ligjshmërinë e saj.

III. Kontratë Prokurimi Publik : Nr. REF- 75334-06-19-2018.

Objekt : *Blerje Materiale Pastrimi,*

Autoritet Kontraktor: *Universiteti Politeknik i Tiranës.*

Nga informacioni i siguruar paraprakisht, nëpërmjet vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, “Vendim K.P.P. 574/2018”, kemi informacion se:

Procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 75334-06-19-2018, me objekt: “*Blerje Materiale Pastrimi*”, me fond limit 2,178,570 lekë pa tvsh është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Universiteti Politeknik i Tiranës. Ky i fundit ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Sipas të dhënave operatorët pjesmarrës kanë qënë 12, nga te cilë, 8 të skualifikuar për shkak të mungesës së dokumentacionit, 3 të skualifikuar me oferta ekonomike dhe oferta e kualifikuar.

¹⁰ <http://www.openprocurement.al/sq/tender/view/id/19274>

Kontrata është lidhur ndërmjet palëve, autoritetit kontraktor “Universiteti Politeknik i Tiranës” dhe kontraktuesit operatori ekonomik “Clean World Profesional”. Procedura e prokurimit me fond limit 2,178,570 lekë pa tvsh, është fituar nga operatori ekonomik “Clean World Profesional” me një vlerë të ofertuar prej 2.076.469 Lek.

Qendra “Për Arsim Cilësor” ka paraqitur një kërkesë për informacion drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranës për t’u njohur me dokumentacionin e plotë të kësaj kontrate. Universiteti refuzon dhënien e informacionit duke u mbështetur në ligjin për prokurimin publik, përkatësisht neni 21, pika 1 dhe pika 3, si dhe neni 25, në të cilën informacioni i kërkuar konsiderohej konfidencial. Menjëherë pas këtij refuzimi, Qendra dërgon një përgjigje sqaruese se përse kërkesa e tyre është e mbështetur në ligj dhe nuk përbën asnjë cënim të procedurave të prokurimit publik përsa kohë procedura ka përfunduar dhe si e tillë ajo duhet të bëhet transparente. Më pas Qendra i është drejtuar institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me një ankesë me objekt refuzimin e dhënies së një informacioni me karakter publik. Komisioneri në fund të muajt shkurt 2020 pranoi pjesërisht ankesën e Qendrës dhe urdhëroi autoritetin publik të kthejë përgjigje dhe të vendos në dispozicion dokumentacionin brenda një afati 10 ditor.

Për shak të situatës së krijuar nga pandemia dhe mosfunksionimit të institucioneve për një periudhë relativisht të gjatë, nuk u arrit marrja e materialeve të kërkuara, edhe pse nxitjet jo formale kanë qënë të vazhdueshme. Në korrik 2020, Qendra i drejtohet institucionit të Komisionerit për të marrë masa për vënien në zbatim të vendimit të tij të urdhërimit si dhe UPT-së për t’i rikujtuar mbi detyrimin për dhënien e informacionit dhe vendimin ende të pa zbatuar të Komisionerit. UPT-së dërgon një link të paaksesueshëm. Pavarësisht komunikimit të Qendrës për pamundësinë e aksesimit të linkut të dërguar, UPT ridërgon të njëjtin link.

Për shkak të mungesës së transparencës dhe mosveprimit nga ana e institucioneve publike, Qendra “Për Arsim Cilësor” depozitoi në gjykatën administrative të shkallës së parë një kërkesë padi ndaj Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me objekt detyrimin e Universitetit Politeknik të Tiranës për të dhënë informacionin e kërkuar. Ndërkohë, që kërkesëpadija ndaj institucionit të Komisionerit ka në fokus marrjen e masave nevojshme ligjore për të garantuar të drejtën e informimit. Procesi gjyqësor ka filluar dhe pritet vendimmarrja e gjykatës administrative të shkallës së parë.

Problematikat e evidentuara dëshmojnë për një mungesë bashkëpunimi dhe llogaridhënie nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës, mungesë transparence edhe pas një vendimi urdhërimi nga autoriteti mbikqyrës i të drejtës së informimit, gjë e cila hedh hijet e dyshimit mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes së këtij autoriteti kontraktor në përzgjedhjen e ofertës fituese.

III. Kontratë Prokurimi Publik: REF-66174-04-30-2018

Objekt : Loti 58: Mirëmbajtje e sistem monitorimit të pacientëve, prodhuesi PHILIPS/ose ekuivalent”,

Autoritet Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Organizata “*Together for Life*” për sigurimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit publik i është drejtuar, bazuar në ligjin “*Për të drejtën e informimit*”, me kërkesë për informacion autoritetit kontraktor, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë (QSUT). Autoriteti Kontraktor refuzoi vendosjen në dispozicion të materialeve të kërkuara dhe e adresoi sigurimin e këtij materiali në portalin e Agjencisë së Prokurimit Publik, duke dërguar vetëm kontratën publike me operatorin ekonomik Health&Light, pa informacionet e tjera, me pretendimin e konfidencialitetit.

Vlen të theksohet se për këtë çështje është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit me qëllim arritjen e sigurimit të informacionit të plotë. Pas ndërhyrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe shumë dërgime dhe ridërgime të kërkesës, si dhe duke sqaruar se informacioni i kërkuar nuk është në kundërshtim me shtojcën numër 4 të DST-së (pretendimi i QSUT-së), e cila në fakt kufizon informacionin sekret të një kompanie, por jo dokumentacione të tilla, si: raportet përmbledhëse për përzgjedhjen e fituesit apo realizimin e kontratës nga Operatori Ekonomik.

Nga studimi i dokumentacionit të siguruar, kontrata e prokurimit rezulton në Regjistrimin e Parashikimeve të Autoritetit Kontraktor si procedurë prokurimi dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara ligjërisht, si: numrin e prokurimit, temën, fondin e parashikuar, vlerën totale dhe vjetore, llojin e procedurës, datat përkatëse për fillimin e procedurës, lidhjen e kontratës, si dhe kohëzgjatjen. Rezulton se plani i prokurimeve është ndryshuar dy herë për shkak të mosrealizimit të procedurës së tenderimit në afatet e parashikuara. Këto ndryshime nuk janë të pasqyruara qartë në planin fillestar të prokurimeve. Planin e prokurimeve e ka të përcaktuar qartëpajisjet që kërkon të mirëmbajë që bëhet fjalë për pajisjet Philips (shprehur që në titullin e tenderit).

Prokurimi është zhvilluar në kohën e parashikuar sipas planit të prokurimeve, ku vlera e parashikuar dhe e vlerësuar ishte 4,983,409.44 ALL, vlera e kontratës është 4,983,000 ALL, ndërkohë që vlera e paguar rezulton të jetë 4,135,423 ALL. Rezulton se sasia e shërbimit të parashikuar dhe të ofruar përputhen njëri me tjetrin.

Afatet e vendosura për aplikim janë të arsyeshme (sipas ligjit) dhe nuk kanë ndryshuar. Teksti i thirrjes së hapur për tender është i kuptueshëm dhe mund të quhet neutral për sa kohë që, përveç fjalës *Philips*, është shkruar edhe *Ekuivalenti*. Dosja e tenderit përmban të gjitha elementet e përcaktuara në ligj dhe përkatësisht: udhëzimet për ofertën, llojin e ofertës, kushtet dhe udhëzimet për verifikimet, llojin e kontratës, specifikimet teknike, cilësinë, sasinë dhe përshkrimin e produktit, punëve dhe shërbimeve, mënyrën e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë, afatet për kontratën, vendin e zbatimit të kontratës, planin dhe dokumentacionin teknik, format e përlogaritjes së kostos së ofertës etj. Dokumentet e tenderit rezultojnë të jenë të publikuara në përputhje me ligjin në portalin e Agjencisë së Prokurimeve Publike në internet.

Në dokumentacionin e tenderit nuk janë të përcaktuara mënyrat e garancisë financiare për zbatim nga ana e ofertuesit për shkak se nuk është e kërkuar me ligj. Ndryshime në dokumentacionin e tenderit nuk ka pasur dhe nuk ka qenë nevoja për të paguar për të marrë dokumentet e tenderit.

Nuk mund të themi që kushtet e kualifikimit janë të formuluar në formë diskriminuuese. Gjithsesi, në rastet kur pajisjet janë të një kompanie (në këtë rast Philips), kjo lë vend për diskutim.

Kriter për vlerësimin e kontratës është çmimi më i ulët, i cili ligjërisht merret parasysh pasi të gjithë ofertuesit kanë kaluar pjesën e kualifikimit teknik. Në rast se nuk kalohet pjesa e kualifikimit teknik, nuk vjohet dot me kriterin ekonomik.

Tenderi është mbyllur dhe ofertuesi ka siguruar një ofertë të pavarur. Hapja e tenderit përmban disa prej informacioneve të parashikuara ligjërisht: Datën dhe kohën e hapjes së ofertës, titullin dhe vlerën e prokurimit, emrat e anëtarëve të komisionit të prokurimit, numrin e ofertës, informacionin lidhur me kriteret. Ndërkohë nuk janë emrat e ofertuesve pjesëmarrës në tender për shkak se aplikimi është bërë në mënyrë elektronike, nuk ka emra të tjerë të personave prezent, nuk ka mundësi uljeje nga ofertuesit, problemet e ofertave të identifikuar dhe ankesa të përfaqesve të ofertuesve për procedurën e hapjes së tenderit.

Për tenderin është mbajtur një raport përmbljedhës për vlerësimet e komisionit për ofertat. Raporti përmbljedhës përmban të gjitha elementet e nevojshëm. Vlen të përmendet se ligji shqiptar nuk e ndalon një ofertues të vetëm për të marrë pjesë në tender.

Në rastin në fjalë, ofertuesi është i vetëm dhe ka fituar tenderin. Nuk ka pasur refuzim të ofertuesve për shkak se nuk ka pasur ofertues të tjerë dhe shuma totale e ofertuesit fitues është 4,983,000 ALL. Kontrata duhet të ishte lidhur më 1 qershor, por për shkak të procedurave ligjore është lidhur në muajin gusht. Rezulton se janë zbatuar procedurat ligjore për kontratën, por jo afatet kohore. Totali i kontratës ka qenë vetëm gjashtë muaj për shkak se nga muaji shkurt deri në korrik kanë zgjatur procedurat e tenderimit dhe vetëm në gusht është bërë e mundur lidhja e kontratës.

Ofertuesi fitues ka dy pronarë me 75% dhe 25% të aksioneve. Për vitin 2018, shuma e kontratës së prokurimit të fituar ishte sa 10% e buxhetit vjetor të ofertuesit. Llogaria e tij bankare nuk është bllokuar gjatë kohës së prokurimit publik dhe ai ka vijuar punën normalisht. Ofertuesi fitues (operatori ekonomik) është krijuar në 30.10.2014.

Zbatimi i kontratës ka filluar menjëherë pas lidhjes së saj. Shuma për pagesat e shërbimeve nuk përputhet me kontratën, sipas së cilës vlera duhet të ishte likuajduar deri më 31 dhjetor. Kontrata nuk përmban anekse për ndryshime të mëtejshme.

Për këtë kontratë është konsultuar portali i dedikuar prokurimit publik “Open Procurement Public Health Sector¹¹, i cili pasqyron të gjitha procedurat e prokurimit publik të zhvilluara në vend. Në lidhje me këtë procedurë kontatohet vendosja e një Red Flag (flamuri të kuq) për mungesë konkurrence. Siç u konstatua edhe në analizë, në këtë procedurë pati vetëm një ofertues, i cili nuk siguron parimin e konkurrueshmërisë, por nga ana tjetër, ligji shqiptar e pranon kryerjen e prokurimit edhe pa praninë e konkurrentëve. Nuk ka pasur ankesa.

¹¹ <http://openprocurement.al/sq/htender/view/id/14913>

IV. Kontratë Prokurimi Publik : REF-48682-02-16-2018

Objekt : Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (catering) për Spitalin Universitar të Traumës

Autoritet Prokurues: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

Institucion Kontraktues: Spitalin Universitar të Traumës

Organizata “Together for Life - TFL” ka bërë kërkesën për informacion për këtë kontratë prokurimi publik e cila fillimisht i është dërguar Ministrisë së Brendshme, si autoritet që ka nën varësi Autoritetin Prokurues, Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Pas mungesës së përgjigjes, TFL iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Informacioni u mor pjesërisht nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe pjesërisht nga Spitali i Traumës.

Veçantia e kërkesës për informacion të kësaj kontrate qëndron në faktin se pas një sorrollatjeje të gjatë sa nga një institucion tek tjetri, nga ana e shoqatës “Together for Life”, për shkak të mungesës së transparencës nga ana e institucioneve publike, u vendos hartimi i kërkesë-padisë dhe dërgimi në gjykatë i vendimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit për mbylljen e çështjes dhe Spitalin e Traumës dhe Ministrinë e Brendshme për mospajtimin e kontratës të lidhur me operatorin ekonomik. Në përfundim të procesit, gjykata i urdhëroi institucionet publike përgjegjëse që t’i sigurojnë TFL-së kontratën e lidhur me operatorin ekonomik. Ndërkohë që vazhdon ankimi në gjykatën administrative të apelit për rrëzimin e pretendimit ndaj Komisionerit për të Drejtën e Informimit për përfundimin e pabazuar të ankimit të organizatës përse kohë që autoriteti publik nuk e ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga shoqata.

Nga studimi i dokumentacionit të siguruar rezulton se në faqen e Agjencisë së Prokurimeve Publike, në regjistrin e parashikimeve, nuk ndodhet planifikimi i tenderit të ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës. Në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-48682-02-16-2018, me objekt “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 134.814.264 lekë (pa TVSH).

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Nika” sh.p.k. & ”Dajti Park 2007” sh.p.k. 108.636.691 lekë, kualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Alar Food & Service” sh.p.k. & ”Serenissima Ristoracione” SPA 113.267.057,65 lekë, kualifikuar
3. “Sori - Al” sh.p.k. 133.680.083,68 lekë, kualifikuar
4. “Silver” sh.p.k. 0 lekë, skualifikuar

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alar Food & Service” sh.p.k. & ”Serenissima Ristoracione” SPA” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi. Referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për

vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Gjithashtu, ky operator ka paraqitur ankesë dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime.

Sa më sipër shpjeguar në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit theksojmë se, ndërsa KVO shpalli fitues “Nika” shpk dhe “Dajti Park 2007” shpk, nga ana e KPP-së, pas shqyrtimit të ankesës së Sori-AL, kualifikoi vetëm këtë të fundit, ndërkohë që deklaroi se ofertuesit e tjerë nuk plotësonin kriteret teknike, ku më i rëndësishmi ishte numri i punëtorëve të gatimit që, sipas kërkesave të tenderit, duhet të ishte 35, ndërkohë që fituesi “Nika” shpk kishte vetëm 11, si dhe mungesa të ambienteve të gatimit (këto janë vetëm disa nga arsyet e skualifikimit).

Për shkak të apelimit të vendimit të KVO-së nga operatorët ekonomikë dhe më pas apelimit të vendimit të KPP-së nga vetë Ministria e Brendshme, vendimi përfundimtar i KVO-së nga data 29 mars 2018 (vendimi i parë) u shpall më 3 shtator 2018, duke çuar kështu në vonesë në lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues. Që nga marrja e vendimit dhe deri në lidhjen e kontratës nuk dihet sa kohë ka kaluar, pasi nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është siguruar kontrata dhe nuk dihen as detajet e zbatimit të saj.

Ndërkohë, lidhur me operatorin fitues, rezulton se operatori Sori-Al është regjistruar në QKB më 10 mars 2003, shuma totale e tenderit përbën 46% të të ardhurave vjetore të kompanisë në vitet 2014-2016 dhe 39% të të ardhurave vjetore të kompanisë për vitin 2017, nuk ka pasur probleme me tatim-taksat dhe ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur sipas kërksave të DST-së. Në listëpagesat e këtij operatori rezultojnë mbi 150 punonjës.

Kështu, konstatojmë sërish një vendim të Komisionit të Prokurimit Publik i cili vendos jo vetëm për mospranim të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, por skualifikon edhe të gjithë operatorët e tjerë duke lënë si ofertë të vlefshme vetëm fituesin.

Për këtë kontratë është konsultuar portali i dedikuar prokurimit publik Open Procurement Albania¹² i cili pasqyron të gjitha procedurat e prokurimit publik të zhvilluara në vend. Në lidhje me këtë procedurë kontatohet vendosja e një Red Flag (flamuri të kuq) për arsyen e skualifikimit të të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe kualifikimin e vetëm një operatori ekonomik, atë fitues.

Gjithashtu, nga portali Open Spending Data, rezulton se operatori Sori-Al është operatori fitues i kësaj procedure prokurimi prej të paktën vitit 2010¹³.

Kur flitet për transparencën të institucionit shëndetësor “Spitali Universitar i Traumës”, Auditi i KLSH-së që në fund të vitit 2018 ka deklaruar¹⁴:

- SUT nuk ka përgatitur programin e transparencës ku të përcaktojë kornizën ligjore të veprimtarisë së tij, si një mënyrë konkrete përmes së cilës SUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit për të drejtën e informimit duke e përditësuar herë pas here programin e transparencës.

¹² <http://openprocurement.al/sq/agency/view/id/142>

¹³ http://spending.data.al/sq/treasury/list/faqe/4/year/2015/inst_code/1017138/perf_id/SORI-AL

¹⁴ http://www.klsh.org.al/web/muaji_hapur_vazhdim_4460.pdf

- Mungon faqja zyrtare në web ku mund të publikohet informacioni i programit që synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SUT-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare i cili duhet të pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afatet kohore për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin (ku çdo dokument duhet të jetë i aksesueshëm edhe në skemë).
- Mungesa e faqes zyrtare të SUT-së nuk mundëson për publikun informacion, pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm dhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve.

Gjithsesi, këto problematika të ngritura nga KLSH dy vite më parë për SUT-në vazhdojnë të jenë aktuale, pasi nga ana e këtij institucioni nuk është ndërmarrë asnjë veprim për rritjen e transparencës.

Ndërkohë, pavarësisht se në KLSH nuk gjejmë një auditim për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit në SUT, në auditimin e vitit 2019 të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për procedurat e prokurimit për shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit në institucione të tjera¹⁵, rezulton se operatori fitues në shumicën e rasteve është operatori ekonomik me ofertën më të lartë, ashtu siç ka ndodhur edhe në këtë kontratë. Në përfundim dhe pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të vendosur në dispozicion për këtë procedurë prokurimi, konstatojmë se është respektuar baza ligjore për prokurimin publik, por në vlerësimin e saj nuk është zbatuar Neni 1 i Ligjit “ Për Prokurimin Publik” i cili parashikon se qëllimi i ligjit është:

“....

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

Skualifikimi i të gjithë operatorëve ekonomikë legjitimon skepticizmin për moszbatim të ligjshmërisë nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, fakti që i njëjti operator shfaqet fitues në një procedurë të caktuar prokurimi për 8 vite rradhazi ul nivelin e besimit në këto institucione dhe në zbatimin e parimeve bazë të prokurimit publik që janë: barazia, mosdiskriminimi, njohja reciproke, proporcionaliteti dhe transparenca.

Për të përdorur të njëjtën mënyrë vlerësimi si Open Procurement kemi të bëjmë me një “Red Flag”, për Komisionin e Prokurimit Publik.

¹⁵ http://www.klsh.org.al/web/06_raport_abp_5859.pdf

IV. Kontratë Prokurimi Publik : Nr.REF-05004-01-24-2019

Objekt: Blerje Materiale Radiologjie për nevojat spitalore

Autoritet Kontraktues: Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”

Pas kërkesës për informacion të shoqatës “Together for Life” për këtë kontratë, nga ana e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, fillimisht u vunë në dispozicion vetëm një pjesë e informacionit të kërkuar, ndërsa dokumentet e tjera nuk u vunë në dispozicion. Pas vënies në dijeni të Autoritetit Kontraktor se, në rast të mosdërgimit të informacioneve të kërkuara, do të vijohej me ankesën tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit, u vunë në dispozicion dokumentet e tjera, me përjashtim të raportit përmbledhës dhe procesverbalit të mbajtur gjatë procedurave të përcaktimit të fituesit.

Shoqata “Together for Life” vendosi ta ankimojë çështjen tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe më 12 qershor 2020, nga ana e Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” u dërguan edhe dy dokumentet e tjera të kërkuara. Vonesat në marrjen e dokumentacionit nga ky institucion janë edhe si pasojë e kthimit të tij në spital Covid-19 që prej fillimit të pandemisë në muajin mars 2020.

Nga studimi i dokumentacionit të siguruar nga SUSHN rezulton se:

Autoriteti kontraktues (SUSHN) kishte parashikuar në planin e prokurimeve, e publikuar në Agjencinë e Prokurimeve Publike, blerjen e materialeve dhe filmave radiologjikë për të plotësuar nevojat e spitalit për vitin 2019. Ky plan përmbante të gjitha elementet e parashikuara në ligj. Në planin e prokurimeve nuk është e sqaruar gjerësisht arsyeja për këtë prokurim, gjithsesi ajo kuptohet qartësisht nga titulli “Blerje materiale radiologjie për nevojat spitalore”. Gjithashtu nuk ka të sqaruar se si është përcaktuar vlera e paraqitur në thirrjen për ofertues, gjithsesi, kjo për faktin se ligji për prokurimet publike nuk e detyron një gjë të tillë.

Plani i prokurimit nuk rezulton të ketë ndryshuar, por gjithsesi duke qenë se është marrëveshje kuadër, theksohet se kontrata dhe blerjet do të jenë në varësi të nevojave të spitalit.

Tenderi është kryer në kohën e parashikuar, gjithsesi vonesa kanë ndodhur për shkak të ankesave të operatorëve ekonomikë dhe, si rrjedhojë, spitali ka vijuar t’i plotësojë kërkesat e veta me negociime, pa shpallje. Kështu, vlera totale e tenderit ishte 4,782,000 lekë, me një total çmimi të përlllogaritur për njësi për çdo artikull 40,600 lekë (120 kuti me 125 filma të përmasave 28x35cm). Ofertuesi fitues ofroi çmimin për njësi për çdo artikull 40,500 lekë (pa TVSH), që është edhe vlera me të cilën është paguar.

Duke qenë se kemi të bëjmë me marrëveshje kuadër, sasia që operatori ekonomik ofron varet nga nevojat e spitalit, është e pamundur përcaktimi i saktë i vlerës së kontratës totale.

Nga ana e institucionit SUSHN është vendosur të vijohet me marrëveshje kuadër për shkak se fondi limit përcakton edhe llojin e procedurës.

Lidhur me realizimin e procedurave që nga shpallja dhe deri në lidhjen e kontratës, konstatojmë se:

Tenderi ishte me procedurë të hapur, ashtu siç ishte parashikuar në planin e prokurimeve. Shpallja e tenderit është bërë nga autoriteti kontraktues dhe ajo përmban të gjitha elementet ligjore.

Një komision për vlerësimin e ofertave (KVO) është ngritur dhe përmban titullin dhe adresën e autoritetit kontraktor, bazën ligjore, titullin e komisionit dhe të vendimit, por procesverbali nuk përmban informacion lidhur me ekspertizën konkrete të pjesëmarrësve në komision, ndërkohë që rezulton se të gjitha anëtarët kanë nënshkruar një deklaratë për konfliktin e interesit.

Afatet kohore të tenderit kanë qenë të arsyeshme (brenda ligjit – 10 ditë), dhe të dhënat e tenderit janë të qarta dhe të shkruara në mënyrë neutrale dhe nuk rezulton të ketë njëanshmëri. Thirrja është teknike, por gjithësi e kuptueshme.

DST përmban të gjitha elementet e parashikuara në ligj. Nga ana e kontraktorit në këtë tender kërkohet sigurimi i kontratës, e cila rezulton (sipas kontratës) që të jetë realizuar nga ana e operatorit ekonomik në shumën 437,400 lekë.

Dosja e tenderit është e plotë në përputhje me përcaktimet ligjore.

Operatori ekonomik (ofertuesi) plotëson të gjitha kushtet për pjesëmarrje në procedurë, çka nënkupton që:

- Është i regjistruar në QKB;
- Nuk është i dënuar për krime ekonomike, korrupsion, mashtrim, keqmenaxhim financiar (një procedurë e tillë bëhet me vetëdeklarim)
- Nuk e ka të ndaluar të zbatojë aktivitete të kërkuara në tender
- Nuk ka probleme me pagimin e taksave apo sigurimeve shoqërore sipas ligjeve në Republikën e Shqipërisë
- Ka një licencë të vlefshme ligjorisht për të zbatuar kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Ofertuesi përmbush kushtet (kriteret e veçanta, pjesa detyruese sipas ligjit) e përcaktuara nga tenderuesi dhe gjithashtu provon ligjorisht që i përmbush këto kushte përmes dokumenteve përkatëse.

Kushtet e kualifikimit nuk rezulton që të jenë të formuluar në mënyrë diskriminuese. Në kontratë parashikohet si fitues ofertuesi që ka ofertën më të ulët, e cila merret parasysh pasi janë vlerësuar kriteret teknike.

Në rastin në fjalë, KVO ka kualifikuar të dy ofertuesit, pavarësisht se për njërin prej ofertuesve ka pasur dyshimet e veta për një detaj teknik. Si rrjedhojë, çështja është ankimuar në KPP nga ofertuesi tjetër, i cili ka pretenduar mosplotësimin e kriterëve teknike nga ofertuesi fitues. Si rrjedhojë, pas shqyrtimit KPP ka skualifikuar ofertuesin me ofertë më të ulët për shkak të mosplotësimit të kriterëve teknike dhe ka mbetur vetëm një ofertues, i cili plotësonte kriteret teknike dhe që është shpallur fitues.

Procesverbali mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit përmban të gjitha elementet e parashikuara nga ligji.

Ofertuesit ishin dy:

- “Almedical” shpk, me ofertë 28,995 lekë pa TVSH/njësi
- “Medfau” shpk me ofertë 40,500 lekë pa TVSH/njësi

Ndërsa KVO shpalli fitues “Almedical” shpk, siç paraqitet edhe në raportin përmbledhës për këtë tender, Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës së Medfaut, e skualifikoi Almedical shpk me pretendimin se ky operator nuk arriti të sigurojë autorizim të drejtpërdrejtë nga kompania prodhuese e filmave radiologjikë, mostrat e të cilave ka paraqitur ditën e ofertimit.

Për shkak të apelimit të vendimit të KVO-së nga operatorët ekonomikë, vendimi përfundimtar i KVO-së nga data 18 shkurt 2019 (vendimi i parë) u shpall më 3 prill 2019, duke çuar kështu në vonesë në lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik fitues dhe ndërkohë duke vijuar me lidhjen e kontratës në 23 prill 2019.

Ndërkohë, lidhur me operatorin fitues rezulton se operatori ekonomik Medfau shpk është regjistruar në QKB më 25.11.1999, shuma totale e tenderit përbën 0.9% të të ardhurave vjetore të kompanisë, nuk ka pasur probleme me tatim-taksat dhe ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur sipas kërksave të DST-së. Ka vetëm një pronar me 100% të aksioneve.

Për këtë kontratë është konsultuar portali i dedikuar prokurimit publik “Open Procurement Public Health Sector”¹⁶, i cili pasqyron të gjitha procedurat e prokurimit publik të zhvilluara në vend. Në lidhje me këtë procedurë kontaktohet vendosja e një Red Flag (flamuri të kuq) për skualifikim të të gjithë operatorëve konkurrues përveç fituesit. Fituesi u konfirmua sipas vendimit të KPP-së, vendim i cili u zbatua edhe nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”.

Për kërkesat e kryera nga shoqata “Together for Life” për institucionet spitalore shëndetësore duhet theksuar se:

Nga ana e spitaleve keqpërdoret neni 17 i Ligjit për të Drejtën e Informimit, i cili lidhet drejtpërdrejt me shtojcën 4 në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST). Neni 17/1 thotë: *E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat.*

Gjithsesi, po aty thuhet se “pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij”. Gjithashtu, në Shtojcën 4 të DST-së, thuhet qartazi se *nuk përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.*

Si rrjedhojë, informacioni i kërkuar nga shoqata "Together for Life" (dhe në vijim nga shoqata të tjera), i cili lidhet drejtpërdrejt me interesin publik, është në përputhje me ligjin dhe si i tillë, duhet të sigurohet. Qartësojmë se ligji kur ka parashikuar informacionin konfidencial me

¹⁶ <http://www.openprocurement.al/sq/htender/view/id/17812>

Operatorin Ekonomik, ka nënkuptuar informacione teknike të cilat nuk përfshihen në kërkesat për informacion për përdorimin e fondeve publike.

Nuk mund të përfshihet në sekretin tregtar kontrata me operatorin ekonomik, si dhe zbatimi i saj. Gjithashtu, nuk mund të hyjë në “sekrete” procesverbalet që bëjnë të ditur arsyet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të caktuar. Kjo për faktin, se si përzgjedhja, ashtu edhe kontrata dhe dokumentet që mbështesin zbatimin e saj, janë të lidhura drejtpërdrejt me mënyrën se si janë përdorur fondet publike nga Autoriteti Kontraktor dhe si rrjedhje, siç përmendet në ligj në nenin 17 dhe në DST në shtojcën 4, bëhet fjalë për dhënien e një informacioni për një interes publik më të lartë për aq kohë sa ky informacion synon mbrojtjen drejtpërdrejt të interesit publik për përdorimin e parave publike.

Në konkluzion përfundimtar të kësaj analize konstatojmë se:

1. Në lidhje me ligjshmërinë dhe arsyet për të prezumuar korrupsion në zhvillimin e këtyre procedurave të prokurimit publik në fusha jetike për qytetarët, si: arsimi dhe shëndetësia, konstatojmë se në zhvillimin e procedurave këto rezultojnë të zhvilluara sipas legjislacionit të fuqi.
Kjo për njëri prej tyre pohohet edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucioni më i lartë auditues në vend.
2. Konstatim tjetër i rëndësishëm ka të bëjë edhe me rolin e Komisionit të Prokurimit Publik si institucion i krijuar me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Komisioni i Prokurimit Publik është një organ shtetëror specifik, quasi gjyqësor, me juridiksionin për të siguruar mbrojtje ligjore në prokurimin publik. KPP-ja ushtron funksionin e saj sipas parimit bazë të prokurimit publik: transparencës. Komisioni i Prokurimit Publik u krijua me qëllimin për të koordinuar sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, me traditat ligjore të Bashkimit Evropian. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe eficientësinë, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit. Ky funksion i këtij institucioni nuk rezulton të jetë ushtruar nga anëtarët e tij për sa kohë procedurat kanë përfunduar ose me kualifikimin e vlerës më të lartë ose me skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke arritur po kështu tek i njëjti përfundim.
3. Gjithashtu, një tjetër problematikë e rëndësishme është ajo e zgjatjes së afateve gjatë shqyrtimit të procedurave nga ana e KPP-së. Edhe KLSH-ja¹⁷ në raportin e vitit 2020 në lidhje me veprimtarinë e KPP-së konstaton se “Për periudhën 1 janar 2019 deri më 30.09.2019 kemi këto statistika: “Sa më sipër, përgjatë kësaj periudhe janë paraqitur gjithsej 823 ankesa, nga të cilat:
 - ✓ 264 ose 32% janë shqyrtuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 22 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik”.
 - ✓ Ndërsa 559 ose 68% e tyre janë shqyrtuar brenda afatit ligjor.

Për sa u trajtua më sipër për mosrespektimin e afateve të vendimmarrjeve të KPP-së, dolëm në konkluzionin se:

- ✓ Shqyrtimi i ankesave jashtë afatit, sidomos numri i lartë në vitin 2018, i cili është raportuar edhe nga vetë KPP-ja në Kuvendin e Shqipërisë, ka ardhur për shkak se institucioni ka qenë në procesin e konstituimit për shkak të kalimit në institucion të pavarur dhe u krijua një vakum kohor;

¹⁷ http://www.klsh.org.al/web/per_web_raport_kpp_19_converted_5606.pdf

- ✓ Shtimi i rasteve të ankesave gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019 të krahasuara me vitet e mëparshme;
- ✓ Shkak tjetër është ardhja me vonesë e informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor; dosjet kanë qenë problematike, voluminoze apo të komplikuar, që kanë dashur marrjen e informacionit të duhur edhe nga organe të tjera kompetente – verifikime në organet që i kanë lëshuar dokumentet, ballafaqime etj. Megjithëse, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, në nenin 72 përcakton edhe penaltete për autoritetet kontraktore në raste të vonesave të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga KPP-ja, në asnjë rast KPP-ja nuk ka kërkuar pranë APP-së marrjen e masave për vendosjen e penalteteve.
- ✓ Gjithashtu, shkak tjetër objektiv për vonesat në shqyrtimin e ankesave brenda afatit është numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore. Konkretisht: Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017 është miratuar në total me 30 punonjës, ku Sektori i Shqyrtimit të Ankesave përbëhej nga 15 punonjës: 1 Përgjegjës Sektori dhe 14 Inspektorë, nga të cilët Përgjegjës Sektori dhe 5 pozicione inspektorë kanë qenë vakante (6 pozicione gjithsej)”.
 4. Gjithashtu, një element tjetër me rëndësi është edhe vendosja në shumicën e këtyre procedurave të Red Flag nga ana e Open Procurement ku një shënim me RedFlag është një fakt, ngjarje ose grup i rrethanave ose informacione të tjera që mund të tregojnë një shqetësim apo ekspozim dhe mbi rrezik potencial të pajtueshmërisë ligjore për sjellje të paligjshme ose joetike të biznesit, veçanërisht në lidhje me praktika korruptive dhe mosrespektimit të ligjeve anti-korrupsion. Vlerësimi për këto kategori do të bëhet në mënyrë automatike, me filtra analitikë të paracaktuar.

Është momenti i duhur që prokurimet publike të vihen mbi bazë të rrepta ligjore të kontrollueshme, të verifikueshme jo vetëm nga auditimi i jashtëm si KLSH, por edhe nga mekanizma të tjerë të mbikëqyrjes dhe parandalimit të abuzimit dhe korrupsionit, që ka munguar në vendin tonë.

Korrupsioni në prokurimet publike çon drejt shtrembërimit të konkurrencës, kufizimit të tregjeve, kufizimin e hyrjeve të reja në treg dhe mosafrimin e investitorëve të huaj.

Roli i ekspertëve monitorues dhe i shoqërisë civile është vendimtar në këto procedura për të rritur llogaridhënien dhe transparencën nga ana e institucioneve përkatëse dhe për të garantuar manaxhimin e mirë të fondeve publike në interes të gjithë shoqërisë.